

24

REPubLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

Adresa: Rr. "Sulejman Delvina" Nr. 1, Tiranë. Tel / Fax: +355 4 2223969, Email: info@acaa.gov.al

Nr. Prot. 910/1

Tiranë, 24/06/2016

VENDIM PER LICENSEN E OPERIMIT PER „ALBAWINGS“ SHPK
Nr. 283 date 24.06.2016

Autoriteti i Aviacionit Civil, në vijim të aplikimit Nr. Prot 074, datë 21.06.2016, të subjektit ALBAWINGS sh.p.k, për t'u pajisur me Liçencë Operimi për Transportin Ajror, në bazë të Ligjit Nr 10040, datë 22.12.2008 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit Nr.17, datë 02.09.2010 "Mbi rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajrore", i ndryshuar, shqyrtoi dhe vlerësoi aplikimin në fjale.

Komisioni i ngritur për këtë qëllim, sipas Urdhrit të Brendshëm Nr. 276, date 22.06.2016 të Drejtorit Ekzekutiv të AAC, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Albawings" shpk për Liçensën e Operatorit Ajror, pasi mori në dorëzim dokumentacionin e dorëzuar nga aplikanti, argumentoi se subjekti i plotëson të gjitha kushtet ligjore për t'u pajisur me license operimi të transportit ajror, sipas Nenit 12 dhe Nenit 13 të Ligjit Nr 10040, datë 22.12.2008 "Kodi Ajror i RSH-se" i ndryshuar dhe Nenit 5 dhe Nenit 6, si dhe Pikes 1 të Aneksit 1 të Udhëzimit të Ministrit të Transportit Nr. 17, date 02/09/2010 "Mbi rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajrore", i ndryshuar, kushte këto të cilat janë të nevojshme për marrjen e një license të operimit të transportit ajror.

Nisur nga sa më sipër, në bazë të Ligjit Nr 10040, datë 22.12.2008 "Kodi Ajror i RSH-se" i ndryshuar, Neni 5/1, Neni 9, pika 1, germa "a", Neni 12 dhe Neni 13 të tij dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrit Nr. 17, datë 2.9.2010 "Mbi rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajrore", i ndryshuar, me propozim të Komisionit për licencimin,

VENDOSA:

1. Me licensen bashkelidhur këtij vendimi, Shoqëria "ALBAWINGS" shpk, autorizohet për të ofruar shërbime ajrore tregëtare, duke kryer transport ajror të pasagjerëve, të postës dhe/ose të ngarkesave, për qëllime fitimi ose qeraje, sic është percaktuar në Çertifikatën e Operatorit Ajror (AOC).
2. Vlefshmeria e kësaj license është e varur nga Certifikata e Operatorit Ajror, e leshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil shqiptar për "Albawings" sh.p.k, ku specifikohen aktivitetet që mbulohen nga Licenca e Operimit. Cdo ndryshim i Certifikates së Operatorit Ajror të Albawings sh.p.k do të pasqyrohet në Licensën e tij të Operimit.

ALEKSANDER LIPIVANI

DREJTOR EKZEKUTIV

